

20151544448

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E
TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 71/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14 dhe 104/15) në nenin 11 pas pikës 35 shtohen pesë pikë të reja 36, 37, 38, 39 dhe 40, si vijon:

„36. "Mbrojtja preventive" është procedurë dhe metodë e intervenimit të drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore me karakter të përkohshëm, që ndërmerret për shkak të pengimit të ndikimeve të ndryshme negative mbi mbrojtjen e ndërtimit, një pjesë e ndërtimit ose lëndës së tundshme, respektivisht mbrojtjes së tyre të përkohshme deri në krijimin e kushteve për ndërmarrjen e masave tjera të domosdoshme të mbrojtjes së ndërsjellë.

37. "Anastiloza" është kthim i pjesëve origjinale të mbrojtjes të ndërtimit të mbrojtur në vendin ku kanë qenë dhe me funksion që e kanë pasur paraprakisht.

38. "Sanim" është metodë e intervenimit të drejtpërdrejtë të të mirës së mbrojtur me të cilën kryhet marrje e pjesshme ose përforsim e elementeve konstruktive të të mirës së mbrojtur, pa u ndryshuar pamja e jashtme e ndërtimit dhe pa ndikuar në sigurimin e objekteve fqinje.

39. "Interpolacion" është procedurë dhe metodë e vendosjes së ndërtimit të ri në ambient të vjetër në tërësi monumentale.

40. "Adaptim" është ndryshim i brendisë të ndërtimit të mbrojtur për shkak të kthimit, ndryshimit ose aktivizimit të funksionit të caktuar të ndërtimit në tërësi ose pjesës së sajë, pa ndryshim e elementeve konstruktive të ndërtimit dhe pa u prishur vlerat artistike dhe vlerat tjera të ngjashme ose përmbajtjet e ndërtimit."

Neni 2

Në nenin 56 në paragrafin (4) fjalët "në kuptimin e paragrafëve (2) pikat 3 dhe 4 dhe (3) nga ky nen" ndryshohen me fjalët "konsiderohet person i cili ka titull shkencorë ose të zgjedhur nga sfera e arkeologjisë, në raste kur bartësi e lejes është person juridik nga paragrafi (2) pika 1 dhe 2 të këtij neni ndërsa në raste kur bartësi i lejes është person juridik respektivisht fizik nga paragrafi (2) pikat 3 dhe 4 të këtij neni" si udhëheqës profesionist".

Neni 3

Në nenin 58 në paragrafin (1) në pikën 5 pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhësen "dhe".

Pas pikës 5 shtohet pikë e re 6 si vijon:

„6. Marrëveshje me institucionin publik kompetent për mbrojtjen e rajonit të të cilit kryhen hulumtimet arkeologjike, me çka rregullohet pjesëmarrja e institucionit gjatë ndërmarrjes së masave të mbrojtjes preventive, për konstatimet e tundshme dhe të pa tundshme."

Neni 4

Në nenin 59 në paragrafin (1) në pikën 4 numri "(7)" zëvendësohet me numrin "(9)", ndërsa pika dhe presja në fund të fjalisë zëvendësohen me presje dhe shtohen fjalët "respektivisht të organizojë zbatim të masave të mbrojtjes preventive nga neni 59-a të këtij ligji;"

Neni 5

Pas nenit 59 shtohet titull i ri dhe nen i ri 59-a, si vijon:

"Masat e mbrojtjes preventive të trashëgimisë kulturore"

Neni 59-a

(1) Masat e mbrojtjes preventive për të cilat paraprakisht nuk nevojiten të bëhet hetime konservatore nga neni 82 i këtij ligji dhe të përpunohet projekt konservator nga neni 85 i këtij ligji, janë:

- përshkrim, fiksime dhe mbulime i mozaiqeve të dyshemesë dhe dyshemeve dekorative në vend të hapur me materiale adekuate ose sigurimin e tyre teknik në mënyrë tjetër,
- strehim dhe sigurim i plastikës së gurtë,
- mbështetje e përkohshme e mureve, llaqeve dhe sigurimi i tyre statik,
- përshkrimi, fiksime dhe përfshirje tjera preventive të freskave dhe dekorim i ngjashëm i mureve,
- vendosje e përkohshme e shtresave respektivisht mbulimi i mureve, portaleve, plastikës dekorative, freskave dhe pjesëve tjera të ndërtimit,
- mbulimi i hapësirave ose sigurimi i tyre në mënyrë tjetër,
- ngjitja e qeramikave ose lëndëve të ngjashme me ngjitës i cili është reverzibil ose
- pastrimi i patinës me rrugë mekanike me çka do të pengohet procesi i prishjes ose korrozionit.

(2) Masat e mbrojtjes preventive nga paragrafi (1) i këtij neni sipas llojit të konstatimeve i zbaton institucioni publik kompetent për mbrojtjen e të cilit rajon kryhen hulumtime arkeologjike, gjatë kryerjes së hulumtimeve arkeologjike.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, nëse masat e mbrojtjes preventive janë urgjente dhe pa prolongueshme, dhe nuk ekziston mundësi të njëjtat në afat të volitshëm kohorë ti kryej institucioni publik kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni, ndërmarrjen e masave e organizon udhëheqësi profesionist i hetimeve arkeologjike, në rastet kur te personat profesionist të cilët janë marrë pjesë në hulumtim nuk ka person me status të konservatorit të autorizuar.

(4) Për masat e ndërmarra të mbrojtjes preventive nga paragrafi (1) i këtij neni institucioni publik kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni respektivisht udhëheqësi profesionist i hetimeve arkeologjike përpilon procesverbal dhe raport të cilat së bashku me dokumentacionin në afat prej tetë ditësh nga dita e ndërmarrjes së masave dorëzohen te Drejtoria, ndërsa në rastin nga paragrafi (3) i këtij neni edhe te institucioni publik kompetent për mbrojtje."

Neni 6

Në nenin 74 në paragrafin (1) pas fjalëve "ndërtim i objektit" shtohen fjalët "ose për ndërmarrjen e masave të mbrojtjes së ndërsjellë", ndërsa pas fjalëve "e mira e mbrojtur" shtohen fjalët "respektivisht rajoni i mbrojtur".

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"(2) Me kushtet mbrojtëse konservatore nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen veprimet e prekjes në integritetin e të mirës së mbrojtur respektivisht rajonit të mbrojtur të cilët mendojnë respektivisht buk konsiderojnë të ndërmerren, dhe me ato mund të përcaktohet edhe:

1. Realizimi i gërmimeve dhe hulumtimeve të mbrojtura arkeologjike;
2. Kryerja e hulumtimeve konservatore;
3. përgatitja e studimeve të veçanta; dhe
4. Ndërmarrja e masave tjera të mbrojtjes.

Në paragrafin (4) në fjalinë e dytë shtohet fjali e re, si vijon: "Në shtojcë të vendimit shtohet edhe paraqitje grafike e të mirës së mbrojtur respektivisht rajonit të mbrojtur në të cilin realizohen punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë."

Neni 7

Pas nenit 75-a shtohet titull i ri dhe nen i ri 75-b si vijon:

"Mendim konservator

Neni 75-b

(1) Ndërmarrja e masave të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të ndërtimit në përbërje të zonës së kontaktit të të mirës së mbrojtur, e cila nuk ka status të të mirës së mbrojtur individuale kryhet në bazë të mendimit konservator të lëshuar nga institucioni publik kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore.

(2) Mendimi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të lëshohet, nëse kërkesës për dhënien me qira të sajë i bashkëngjitet projekt themelorë.

(3) Mendimi nga paragrafi (1) i këtij neni jepet në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dhënien e sajë.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen dispozitat neni 85, neni 87 dhe neni 91 të këtij ligji.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit të mendimit konservator nga paragrafi (1) i këtij neni dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton i përcakton ministri i kulturës.

Neni 8

Në nenin 82 pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7) si vijon:

"(7) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, hulumtimet konservatore nuk kryhen gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes preventive në rastet e përcaktuara në nenin 59-a paragrafi (1) të këtij ligji."

Paragrafi (7) bëhet paragraf (8).

Neni 9

Në nenin 85 ne paragrafin (1) në fjalinë e parë shtohet fjali e re, si vijon: "Projektet konservatore për të cilat nevojitet leje në pajtim me rregullat për ndërtim në titullin vet e përmbajnë edhe emrin e projektit sipas dedikimit dhe nivelit të projektit në pajtim me rregullat për ndërtim.

Në paragrafin (2) pas fjalëve "leje " shtohen fjalët "në pajtim me rregullat".

Paragrafi (6) ndryshon si vijon:

"(6) Projekte konservatore përpunojnë institucionet publike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe person tjetër juridik, nëse kanë punësuar ose angazhuar të paktën një person me specializim adekuat që ka status të punëtorit shkencorë ose status të punëtorit profesionist me titull të zgjedhur profesionist në veprim për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ose i cili ka licencë konservatore."

Në paragrafin (6) shtohen dy paragrafë të ri (7) dhe (8) si vijon:

"(7) Me përpunimin e projektit konservator nga paragrafi (6) i këtij neni menaxhon personi me specializim adekuat i cili ka status të punëtorit shkencor ose status të punëtorit profesionist me titull të zgjedhur profesionist në veprim për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ose i cili ka licencë konservatore.

(8) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, projektet konservatore nuk përpunohen gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes preventive në rastet e përcaktuara në nenin 59-a të këtij ligji."

Paragrafi (7) bëhet paragraf (9).

Neni 10

Në nenin 87 në paragrafin (2) pikat 3 dhe 4 shlyhen.

Në pikën 5 e cila bëhet pikë 3 pas fjalëve "mbrojtje e ndërsjellë" shtohen fjalët "në raste kur punët e mbrojtjes së ndërsjellë i realizon institucioni publik kompetent për mbrojtje".

Në paragrafin (7) pas fjalëve "leje e nevojshme" shtohen fjalët "sipas rregullave".

Paragrafi (8) ndryshon si vijon:

"(8) Leja konservatore nga paragrafi (7) i këtij neni, lëshohet për masat e mbrojtjes së ndërsjellë të cilat miratohen në rekunsruksion të pjesshëm ose të plotë, sanim, dislokacion ose adaptim të gjobës së mbrojtur, si dhe interpolacion në pajtim me rregullat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, respektivisht punët e ndërtimit, mbindërtimit, përfundimit të ndërtimit, ridedikimit, adaptimit, adaptimit me ridedikim, rikonstruimit dhe rikonstruimit me ridedikim në pajtim me rregullat për ndërtim."

Në paragrafin (8) shtohen dy paragrafë të ri (9) dhe (10) si vijon:

"(9) për masat e mbrojtjes së ndërsjellë të cilat nuk janë përfshirë me paragrafin (8) të këtij neni lëshohet vetëm leje konservatore.

(10) nëse për punët e parapara me projektin konservator, nevojitet lëshim i lejes adekuate në pajtim me rregullat për ndërtim, Drejtoria është e obliguar në lejen konservatore ti sugjerojë palës për nevojën që të sigurojë edhe leje në pajtim me rregullat për ndërtim."

Paragrafi (9) bëhet paragraf (11).

Neni 11

Në nenin 88 në paragrafin (2) fjalja e dytë shlyhet.

Neni 12

Në nenin 89 në paragrafin (5) në fjalinë e parë shtohet fjali e re, si vijon: "lartësia e shpenzimeve përcaktohet në bazë të llojit dhe vëllimit të masave të mbrojtjes së ndërsjellë në të cilat bëhet mbikëqyrje e konservuar, largësia hapësinore e të mirës së mbrojtur mbi të cilën kryhet mbikëqyrje konservatore nga selia e institucionit publik për mbrojtjen dhe afatin për kryerjen e mbikëqyrjes.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Lartësia e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes konservatore përcaktohet me tarifore që e miraton ministri i kulturës.

Paragrafi (6) bëhet paragraf (7).

Neni 13

Në nenin 90 në paragrafin (1) në pikën 1 pas fjalëve "leje konservatore" shtohen fjalët "mendim konservator,".

Neni 14

Neni 171-b shlyhet.

Neni 15

Në nenin 172 në paragrafin (1) fjalët "3.000 deri" shlyhen.

Pas pikës 1 shtohet pikë e re 2 si vijon:

„2. Ndërmerr masa për mbrojtje preventive në kundërshtim me këtë ligj (neni 59-a)".

Pas pikës 2 e cila bëhet pikë 3 shtohet pike e re 4 si vijon:

„4. Realizon punë për mbrojtje të ndërsjellë pa mendim konservator nga institucioni kompetent publik për mbrojtje (neni 75-a paragrafi (1));".

Pikat 3, 4 dhe 5 bëhen pika 5, 6 dhe 7.

Pas pikës 6 e cila bëhet pikë 8 shtohet pikë e re 9 si vijon:

„9. Personi i pa autorizuar përpunon projekt konservator (neni 85 paragrafi (5));".

Pikat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 bëhen pika 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"(2) Gjoba në shumë prej 30% nga gjoba e llogaritur për personin juridik do ti shqiptohet për shkeljet nga paragrafi (1) i këtij neni, personit përgjegjës në person juridik."

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"(3) Gjoba në shumë nga 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për shkeljen nga paragrafi (1) pikat 1, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të këtij ligji dhe tregtarit individ.

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"(4) Gjoba në shumë prej 30% nga gjoba e matur për tregtarin individ do ti shqiptohet për kundërvajtjet nga paragrafi (1) pikat 1, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të këtij neni personit përgjegjës në tregtar individ."

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (5) fjalët "deri 500" zëvendësohen me fjalët "deri 600", ndërsa numrat "2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17" zëvendësohen me numrat „3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20“.

Në paragrafin (5) i cili bëhet (6) numrat „2, 5, 9, 10, 11, 12 dhe 13“ zëvendësohen me numrat „3, 7, 12, 13, 14, 15 dhe 16“.

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragraf (7) numrat „2, 5, 9, 10, 11, 12 dhe 13“ zëvendësohen me numrat „3, 7, 12, 13, 14, 15 и 16“.

Në paragrafin (7) i cili bëhet paragraf (8) numrat „1, 3, 4, 6, 7, 8, 14 и 15“ zëvendësohen me numrat „1, 5, 6, 8, 10, 11, 17 и 18“.

Neni 16

Në nenin 172-a në paragrafin (1) numri „3.000“ zëvendësohet me numrin „2.000“, ndërsa fjalët "personi përgjegjës, respektivisht" shlyhen

Neni 17

Në nenin 173 në paragrafin (1) fjalët "2.000 deri 2.500" zëvendësohen me fjalët "nga 1,500", ndërsa pas fjalës personi juridik shtohen fjalët "respektivisht tregtar individ".

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

„(2) Gjoba në shume prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik, respektivisht tregtarin individ do ti shqiptohet si kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në person juridik, respektivisht personit përgjegjës në tregtar individ."

Paragrafi (3) shlyhen.

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (3) fjalët "500 deri 700" zëvendësohen me fjalët "150 deri 225"

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Paragrafi (8) bëhet paragraf (7).

Neni 18

Në paragrafin 173-a në paragrafin (1) fjalët "nga 500 deri 700 zëvendësohen me fjalët "200 deri „300 .

Paragrafi (3) shlyhen.

Neni 19

Në nenin 173-b në paragrafin (1) fjalët "deri 6.000" shlyhen.

Në paragrafin (3) fjalët "deri 6.000" shlyhen.

Neni 20

Në nenin 174 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"(2) Gjoba në shumë prej 30% nga gjoba e llogaritur për personin juridik do ti shqiptohet për shkeljet nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në person juridik."

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

(4) Gjoha në shumë prej 30% nga gjoha e matur për personin juridik do ti shqiptohet si kundërvajtje nga paragrafi (1) pikat 8, 9, 10, 11 dhe 18 të këtij neni personit përgjegjës në tregtar individ."

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (5) fjalët "nga 500" zëvendësohen me fjalët "nga 70 deri 100".

Paragrafët (5) dhe (6) bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Neni 21

Në nenin 174-b në paragrafin (7) pas fjalës "organ" shtohen fjalët "e mban procedurën për kundërvajtje në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet dhe".

Paragrafi (10) ndryshon si vijon:

"(10) Kundër vendimit për kundërvajtje që e ka miratuar Komisioni kundërvajtës mund të parashtrahet ankesë te Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje."

Neni 22

Titulli i nenit dhe neni 174-v ndryshojnë si në vijim:

"Matja e lartësisë së gjohës për personin juridik dhe tregtar individ

Neni 174-v

Matja e lartësisë së gjohës për personin juridik, respektivisht për tregtar individ kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet."

Neni 23

Titulli i nenit dhe neni 174-g ndryshojnë si në vijim:

"Procedura për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse

Neni 174-g

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 172, 172-a, 173, 173-a, 173-b dhe 174 të këtij ligji, inspektori për trashëgimi kulturore kryerësit të shkeljes do ti lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes vërehet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të mënjahen pasojat e dëmshme të kundërvajtjes, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave të kryerësit të kundërvajtjes.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës ose personi i autorizuar nga ai.

(5) Inspektori për trashëgimi kulturore është i obliguar të mbajë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(6) Në evidencën nga neni (5) i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, respektivisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesave kundërvajtëse të cilit i lëshohet rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vite nga data e futjes në evidencë.

(8) Ministri i kulturës i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

Neni 24

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozita kalimtare për miratime konservatore

Neni 25

Procedurat e filluara për marrjen e miratimit konservator deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Hyrja në fuqi

Neni 26

Ky ligj në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitës nga neni 7 i këtij ligji që do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2016.